

N<sup>o</sup> 30. Prot



04. 19. 01. 21

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KRYEMINISTRIA  
INSPEKTORATI QENDROR

URDHËR

Nr. 6, datë 19/01/2021

**"PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E KËRKESAVE SPECIFIKE PËR ARSIMIMIN E INSPEKTORËVE NË INSPEKTORATET SHTETËRORE/VENDORE DHE STRUKTURAT E TJERA INSPEKTUESE"**

Në zbatim të germës "f", të pikës 2, të nenit 16 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Inspektorati Qendror, miraton kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore.

Me qëllim formimin profesional të inspektorëve shtetërorë/vendorë për hartimin dhe miratimin e kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore, si dhe inspektorëve të strukturave të tjera përgjegjëse inspektuese;

**URDHËROJ:**

1. Hartimin e kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve shtetërorë/vendor, dhe strukturave të tjera përgjegjëse të inspektimit, sipas fushave të tyre inspektuese.
2. Përfaqësuesit e inspektorateve shtetërore/vendore, si dhe strukturat e tjera përgjegjëse inspektuese, duhet të hartojnë kërkesat specifike për arsimimin për çdo fushë inspektimi, duke bashkëpunuar me Inspektoratin Qendror.
3. Inspektorati Qendror pas hartimit të kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve shtetërorë/vendor, nga çdo inspektorat shtetërorë/vendor, apo strukturë përgjegjëse e inspektimit, bën miratimin e kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve dhe i publikon ato në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror, në adresën: [www.insq.gov.al](http://www.insq.gov.al).
4. Ngarkohen Inspektorati Qendror, inspektoratet shtetërore/vendore, si dhe strukturat e tjera përgjegjëse për inspektimin, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

**INSPEKTORI PËR GJITHSHËM  
SHKËLQIM HAJDARI**